



PLANI I INTEGRITETIT ALBGAZ SHA 2026-2030

Miratuar me Urdhrin nr. 20, datë 24/06/2026 të Administratorit

DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL

Përballja efektive me korrupsionin nga ana e institucionit të Albgaz-it është me rëndësi për arritjen e rezultateve të larta në forcimin e integritetit institucional dhe mirëfunksionimin.

Mbështetur në dokumentet strategjik të miratuar nga Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, e cila ka përgjegjësinë kryesore të hartoje politika në luftën kundër korrupsionit dhe të bëjë monitorimin e zbatimit të tyre nga ana e institucioneve publike në vend, stafi i Albgaz është i vetëdijshëm se duhet t'i shërbejë interesit publik, në mënyrë që të gjitha veprimtaritë tona të jenë me integritet të lartë, me vlera etike dhe të bazuara në ligj.

Plani i integritetit i Albgaz SH.A është shprehje konkrete e vullnetit dhe përkushtimit për integritet institucional, si dhe e qëndrimit proaktiv për të mbështetur përpjekjet dhe reformat antikorrupsion.

Albgaz ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në përmirësimin e kornizës rregullatore dhe operacionale të integritetit. Hapi i miratimit të këtij Plani Integriteti, është pikërisht një përpjekje për të hedhur themelet e një sistemi më të gjerë, i cili menaxhon risqet që kërcënojnë integritetin institucional. Synimet tona, të shprehura në këtë dokument, lidhen me krijimin e një mjedisi që nxit dhe promovon kulturën e integritetit, nëpërmjet një sistemi funksional të menaxhimit të integritetit në Albgaz.

Qëllimi tij është përmirësimi i politikave, rregullave, praktikave të parandalimit të korrupsionit, si dhe forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit.

Plani i Integritetit për institucionin tonë do të ndikojë pozitivisht në axhendat institucionale kundër korrupsionit.

ADMINISTRATOR I ALBGAZ SHA

Amarda Kapaj

Përmbajtja

DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL	0
1. Plani për Integritetin.....	4
1.1 Procesi i zhvillimit të planit të Integritetit.....	4
1.2 Kuadri Ligjor dhe Institucional.....	5
1.3. Qasja metodologjike	6
2. Risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit	10
2.1 Risqe dhe faktorë të risqeve të lidhura me mjedisin e brendshëm rregullator dhe institucional për integritetin	10
2.2. Risqe dhe faktorët e risqeve të lidhura me burimet njerëzore në institucion (burime njerëzore adekuate, të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnime të përshtatshme)	11
2.3. Risqet dhe faktorët e risqeve për transparencën e punës dhe veprimtarisë së Albgaz brenda institucionit, me aktorë të jashtëm të interesuar dhe publikun.	12
3. Plani i veprimit.....	12
3.1 Monitorimi dhe raportimi i Planit të Veprimit	13

SNKK - Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit

PI - Plan Integriteti

BNJ - Burime Njerëzore

GMS - Grupi i Menaxhimit Strategjik

MVRI - Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit

PT - Programi i Transparencës

PSV- Procedura Standarte Veprimi

1. Plani për Integritetin

Plani i Integritetit për AlbgaZ u hartua gjatë periudhës shkurt - maj 2026. Ky plan është hartuar duke u mbështetur në dokumentin e Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit (MVRI) për qeverisjen qendrore dhe vendore. Qëllimi i Planit të Integritetit në këtë institucion është: i) vlerësimi i risqeve të integritetit të cilat komprometojnë aftësinë e AlbgaZ për të kryer veprimtarinë tregtare në shërbim të publikut në mënyrë jodiskriminuese dhe transparente dhe i faktorëve që mund të mbështesin apo rrisin risqet e vlerësuara si dhe ii) formulimi i masave të përshtatshme për adresimin e tyre.

Vlerësimi i risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre është kryer për proceset e punës sipas fushave të veprimtarisë së shoqërisë. Këto fusha përfshijnë: i) fusha e menaxhimit financiar; ii) fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore; iii) fusha e kontrollit dhe e mekanizmave kundër korrupsionit; iv) fusha e transparencës; dhe v) fusha e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve shkresore, si dhe të informacionit e të dokumenteve elektronike; vi) fusha e operimit sektorial.

1.1 Procesi i zhvillimit të planit të Integritetit

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në AlbgaZ konsistoi në zbatimin e fazave të mëposhtme:

1.1.1 Ngritja e Grupit të Punës për hartimin e Planit të Integritetit dhe mobilizimi i stafit të shoqërisë

Administratori i shoqërisë ngriti Grupin e Punës për vlerësimin e riskut të integritetit dhe përgatitjen e Planit të Integritetit të AlbgaZ. Në përbërje të grupit të punës ishin punonjës të shoqërisë të nivelit drejtues (kategoria e lartë dhe e mesme). Grupi i Punës u kryesua nga një kryetar grupi dhe menaxhua nga një koordinator, i cili siguroi mbarëvajtjen e procesit dhe koordinimin e aktiviteteve në institucion.

1.1.2. Identifikimi dhe analiza e riskut

Gjatë kësaj faze, grupi i punës i kushtoi vëmendje të veçantë analizës së kuadrit ligjor dhe atij të brendshëm rregullator për veprimtarinë e institucionit. Grupi i Punës vijoi me identifikimin dhe analizimin e risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre. Pjesë e kësaj analize ishin edhe të dhënat cilësore të grupeve të fokusuara me punonjësit e institucionit. U realizuan 6 dëgjesa në grupe, me stafin e sektorëve të institucionit.

1.1.3. Vlerësimi i risqeve të integritetit

Gjatë kësaj faze, grupi i punës vlerësoi intensitetin e risqeve të analizuara në fazën e mësipërme. Grupi i Punës identifikoi dhe analizoi faktorët e riskut që mund të pritët të mbështesin ose rrisin risqe të tilla. Gjatë kësaj faze të procesit u krye edhe një analizë për fushat e veprimtarisë që kërkonin vlerësim më të detajuar për shkak të ekspozimit të tyre më të madh ndaj risqeve të integritetit. Në vijim risqet e vlerësuara dhe faktorët

e tyre u renditën sipas përparësisë. Procesi vijoi me vlerësimin e efektivitetit të masave ekzistuese të kontrollit në institucion për risqet e vlerësuara dhe me propozimin e masave të reja për trajtimin e tyre. Në këtë fazë të procesit kontribuan gjithashtu diskutimet dhe feedback-u i marrë nga fokus grupet me stafin e drejtorive të ndryshme të shoqërisë.

1.1.4. Plani i Veprimit për Menaxhimin e Riskut

Grupi i Punës hartoi Planin e Veprimit për menaxhimin e risqeve të integritetit në institucion, i cili përfshiu masa të reja kontrolli apo përmirësimin e masave ekzistuese. Masat përshkruajnë aktivitetet që duhet të zbatohen për zvogëlimin apo eliminimin e risqeve të integritetit, afatet kohore dhe përgjegjësitë për zbatimin e tyre.

1.2 Kuadri Ligjor dhe Institucional

Plani i Integritetit i Albgaz është hartuar në mbështetje të legjislacionit shqiptar për parandalimin e korrupsionit, forcimin e integritetit publik dhe administrimin e riskut institucional, si dhe në përputhje me aktet e brendshme rregullatore të shoqërisë.

Hartimi dhe zbatimi i Planit të Integritetit mbështetet në:

- Urdhrin nr. 334, datë 20.02.2020 të Ministrit të Drejtësisë "Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore";
- Ligjin nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve";
- Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit";
- Ligjin nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9131/2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike";
- Ligjin nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror".
- Legjislacionin sektorial që rregullon veprimtarinë e sektorit të gazit natyror;
- Statutin, Kodin e Etikës, Rregulloren e Brendshme dhe aktet e tjera të brendshme të Albgaz sh.a.

Në zbatim të këtij kuadri ligjor dhe institucional, Albgaz ka ngritur strukturat përgjegjëse për administrimin e konfliktit të interesit, mbrojtjen e sinjalizuesve, mbrojtjen e të dhënave personale dhe menaxhimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm, të cilat përbëjnë elemente thelbësore të sistemit të integritetit institucional.

Ky Plan Integriteti përfaqëson dokumentin bazë për identifikimin, trajtimin, monitorimin dhe reduktimin e risqeve të integritetit në Albgaz dhe do të shërbejë si referencë për përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të qeverisjes, transparencës dhe etikës profesionale në shoqëri.

1.3. Qasja metodologjike

Hartimi i Planit të Integritetit të Shoqërisë ALBGAS sh.a. është realizuar në përputhje me Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për institucionet publike, me qëllim identifikimin, analizimin dhe trajtimin e risqeve që mund të ndikojnë në integritetin institucional, transparencën, paanshmërinë dhe përputhshmërinë me kuadrin ligjor në fuqi.

Procesi i vlerësimit është bazuar në një qasje sistematike dhe pjesëmarrëse, e cila ka përfshirë analizën e proceseve të punës, identifikimin e pikave të cenueshme, vlerësimin e probabilitetit dhe ndikimit të risqeve, si dhe përcaktimin e masave korrigjuese për minimizimin e tyre.

1.3.1 Organizimi i procesit

Për realizimin e procesit të vlerësimit të riskut të integritetit, është ngritur Grupi i Punës me urdhër të Administratorit të Shoqërisë ALBGAS sh.a., i përbërë nga përfaqësues të strukturave kryesore organizative.

Grupi i Punës ka pasur si detyrë:

- koordinimin e procesit të vlerësimit të riskut;
- mbledhjen dhe analizimin e informacionit;
- administrimin e pyetësorëve;
- identifikimin e risqeve të integritetit;
- hartimin e Regjistrat të Riskut;
- formulimin e masave korrigjuese dhe të planit të monitorimit.

1.3.2 Burimet e informacionit

Vlerësimi i riskut të integritetit është mbështetur në burime të ndryshme informacioni për të siguruar një analizë sa më objektive dhe të plotë.

Analiza dokumentare

Janë analizuar dokumente dhe akte të brendshme të ALBGAS sh.a., përfshirë:

- Statutin e shoqërisë;
- Rregulloren e brendshme;
- Strukturën organizative;
- Përshkrimet e vendeve të punës;
- Kodin e Etikës;
- Procedurat administrative;
- Dokumentacionin mbi konfliktin e interesit;
- Dokumentacionin mbi sinjalizimin.
- Programin e Transparencës;
- Dokumentacionin mbi mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë e informacionit;

Intervista dhe konsultime

Janë zhvilluar konsultime me drejtues dhe punonjës të strukturave përkatëse me qëllim identifikimin e proceseve më të ekspozuara ndaj riskut të integritetit dhe vlerësimin e efektivitetit të mekanizmave ekzistues të kontrollit.

Pyetësori i vetëvlerësimit

Punonjësit e ALBGAS sh.a. u përfshinë në proces nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve të anonimizuar, të cilët shërbyen për mbledhjen e informacionit mbi:

- njohjen e rregullave etike;
- konfliktin e interesit;
- regjistrimin e dhuratave;
- mekanizmat e sinjalizimit;
- transparencën;
- kulturën e integritetit në institucion.

Rezultatet e pyetësorit janë përdorur si një nga burimet kryesore për identifikimin dhe priorizimin e risqeve.

1.3.3 Identifikimi i risqeve të integritetit

Identifikimi i risqeve është kryer në bazë të analizës së proceseve kryesore të veprimtarisë së ALBGAS sh.a.

Për secilin proces janë analizuar:

- aktivitetet kryesore;
- pikat e kontaktit me palët e interesit;
- diskrecioni në vendimmarrje;
- niveli i kontrollit të brendshëm;
- mundësitë për konflikt interesi;
- ekspozimi ndaj favorizimit ose ndikimeve të papërshtatshme;
- rreziqet që lidhen me transparencën dhe llogaridhënien.

Gjatë këtij procesi janë marrë në konsideratë vetëm risqet e integritetit, ndërsa risqet operacionale, financiare apo teknike që nuk lidhen drejtpërdrejt me integritetin institucional nuk janë përfshirë në Regjistrin e Riskut.

1.3.4 Vlerësimi i risqeve

Për secilin risk është kryer vlerësimi sipas dy dimensioneve kryesore:

Probabiliteti

Probabiliteti paraqet mundësinë që risku të ndodhë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së institucionit.

Vlera	Përshkrimi
1	Shumë i ulët
2	I ulët
3	Mesatar
4	I lartë
5	Shumë i lartë

Ndikimi

Ndikimi paraqet pasojat që mund të shkaktojë risku në integritetin, reputacionin dhe funksionimin e institucionit.

Vlera	Përshkrimi
1	Shumë i ulët
2	I ulët
3	Mesatar
4	I lartë
5	Shumë i lartë

Niveli i riskut

Niveli i riskut është përcaktuar duke kombinuar probabilitetin me ndikimin sipas formulës:

$$\text{Risku} = \text{Probabiliteti} \times \text{Ndikimi}$$

Në bazë të rezultatit, risqet janë klasifikuar si:

Niveli
I ulët
I moderuar
I lartë

1.3.5 Prioritizimi i risqeve

Pas vlerësimit të tyre, risqet janë renditur sipas nivelit të ekspozimit dhe efektit potencial mbi integritetin institucional.

Prioritet u është dhënë risqeve që:

- lidhen me konfliktin e interesit;
- lidhen me sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve;
- lidhen me menaxhimin e dhuratave;
- ndikojnë në transparencën dhe llogaridhënien;
- mund të cenojnë paanshmërinë e proceseve vendimmarrëse;
- mund të ndikojnë në reputacionin e ALBGAS sh.a.

1.3.6 Hartimi i masave korrigjuese dhe monitorimi

Për çdo risk prioritar janë identifikuar masa korrigjuese me qëllim reduktimin e probabilitetit të ndodhjes së tij ose minimizimin e ndikimit të mundshëm.

Për secilën masë janë përcaktuar:

- struktura përgjegjëse;
- afatet e zbatimit;
- indikatorët e monitorimit;
- burimet e verifikimit;
- frekuenca e monitorimit.

Monitorimi i Planit të Integritetit do të realizohet në mënyrë periodike nga strukturat përgjegjëse, ndërsa rezultatet do të përdoren për përditësimin e Regjistrisë të Riskut dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të masave të integritetit në ALBGAS sh.a.

2. Risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit

Në këtë seksion është paraqitur një përshkrim i përmblendhur i risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre, të analizuar sipas fushave të veprimtarisë së Albgaz dhe të kategorizuara si më poshtë:

2.1 Risqe dhe faktorë të risqeve të lidhura me mjedisin e brendshëm rregullator dhe institucional për integritetin

Albgaz ka hartuar dhe miratuar një numër dokumentesh strategjike institucionale për aspekte të integritetit, të tilla si: Kodi i Etikës, Struktura me Përshkrimin e Punës, Manuali i Burimeve Njerëzore, rregullore mbi Bilbilfryrësin, si dhe Programi i Transparencës i cili është i publikuar dhe përditësohet rregullisht.

Ndërkohë janë të plota rregullat për procedurën e hetimit dhe shqyrtimit të sinjalizimeve dhe veprime ose praktika të dyshuara korrupsioni etj.; mekanizma funksionale trajnimi për zbatimin e kodit si vlerësimi i standardeve etike të Kodit apo interpretimi i Kodit. Përmblendhja tërësore e vlerave dhe parimeve të Kodit të Etikës duhet të udhëheqë drejtuesit e institucionit në sjelljen dhe veprimet e tyre gjatë ushtrimit të funksioneve dhe angazhimeve si përfaqësues të funksionit ekzekutiv.

Albgaz ka hartuar dhe miratuar kuadrin rregullator të brendshëm të shoqërisë. Ky kuadër paraqet paqartësi në: reflektimin e strukturës së brendshme institucionale pasi

struktura është miratuar së fundmi, në janar 2025, ndërsa përshkrimet e punës janë të pandryshuara që nga viti 2017.

Nga shqyrtimi i kuadrit të brendshëm rregullator rezulton se ka rregulla specifike për regjistrimin, hetimin dhe shqyrtimin e sinjalizimeve dhe veprimeve ose praktikave të dyshuara korruptive. Shoqëria tashmë ka ngritur njësinë përkatëse në institucion.

Dokumente apo akte të tjera rregullatore, që janë hartuar në institucion dhe që përmirësojnë mjedisin e brendshëm për integritet, janë: dokumenti politik për menaxhimin e riskut të brendshëm i cili përcakton standardet që duhen përdorur në Albgaz për të administruar riskun me të cilin ekspozohet institucioni gjatë kryerjes së aktivitetit të tij të përditshëm.

(Strategjia e Menaxhimit të Riskut

https://Albgaz.al/wp-content/uploads/2026/03/Strategjia_Albgaz.pdf).

Disa nga sfidat që identifikohen shpesh në mjedisin e brendshëm institucional janë:

- Kuadër rregullator specifik për integritetin i paplotë me rregulla dhe procedura të qarta për aspekte të vecanta të integritetit;
- Ekzistojnë mundësi për përmirësim të mëtejshëm të kuadrit të brendshëm institucional për menaxhimin e çështjeve të integritetit.

2.2 Risqe dhe faktorët e risqeve të lidhura me burimet njerëzore në institucion (burime njerëzore adekuate, të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnime të përshtatshme)

Mirëfunksionimi i shoqërive tregtare ka linja të qarta hierarkike, manual me standard të proceseve të punës për çdo njësi të institucionit, ndryshe Procedura Standarde Veprimi (PSV), si dhe për promovimin dhe përqafimin e standardeve dhe parimeve të sektorit ku operon. Këto elemente nxisin një kulturë integriteti për institucionin.

Nga shqyrtimi i kuadrit të brendshëm rregullator të institucionit rezulton që të gjitha drejtoritë e institucionit të kenë PSV/ dokumente që rregullojnë në detaje proceset e punës të realizuara nga çdo strukturë/funksion i institucionit.

Albgaz ka një organikë të miratuar me 113 punonjës nga të cilët 27 prej tyre janë vakantë. Nga 27 vakanca gjatë periudhës së hartimit të këtij Plani, vetëm 2 janë në pozicione drejtuese, pjesa tjetër janë nga drejtoria teknike si dhe 2-3 specialiste nga drejtori të tjera, duke mos e cënuar aspak mbarëvajtjen e punës në shoqëri.

Strukturat institucionale antikorupsion dhe ato të ndërtimit të integritetit, që përfshijnë: Grupin e Menaxhimit Strategjik, Koordinatorin e Riskut Financiar, Koordinatorin për të Drejtën e Informimit, si dhe Njësinë për Sinjalizimin në këtë

strukturë; paraqesin një kuadër të brendshëm rregullator të mirë në përgjithësi, por që mund të përmirësohet edhe më tej, bazuar në eksperiencën e arritur deri më tani.

2.3. Risqet dhe faktorët e risqeve për transparencën e punës dhe veprimtarisë së Albgaz brenda institucionit, me aktorë të jashtëm të interesuar dhe publikun.

Nga analiza përmbajtësore e faqes zyrtare të internetit të Albgaz vihet re se publikohen të dhëna dhe informacione të përgjithshme dhe me karakter informues si për publikun dhe grupet e interesit ashtu edhe për operatorët e sektorit. Gjithashtu, për shkak të karakterit konfidencial të tyre, nuk janë të publikuara informacione dhe dokumente që lidhen me kontrata sektoriale.

Albgaz ka të përcaktuar nga titullari edhe një Koordinator për të Drejtën e Informimit, i cili ka pasur kontakte të vazhdueshme me institucionet përkatëse publike si dhe grupet e interesit. Transparenca e veprimtarisë së institucionit është ndikuar shumë nga komunikimi efektiv i brendshëm, i deritanishëm, ndërmjet drejtorive dhe nga Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.

Programi i Transparencës (PT) përfaqëson një instrument që kontribuon për transparencën dhe përgjegjshmërinë e institucionit, një detyrim i përcaktuar në ligjin për mbrojtjen e së drejtës për informim. Programi është i publikuar dhe përditësohet rregullisht nga Koordinatori për të Drejtën e Informimit,

3. Plani i veprimit

Plani i Veprimit përfshin tërësinë e masave për të adresuar risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit të identifikuar sipas 6 fushave të përgjegjësisë së Albgaz. Ai është një mjet plotësues i politikave dhe kornizës rregullatore për përmirësimin dhe forcimin e integritetit institucional.

Plani ka për qëllim arritjen e objektivave për forcimin e integritetit si më poshtë:

1. Procese dhe rregulla të qarta mbi aspektet e integritetit në Albgaz në mënyrë që të minimizohet cenimi i tyre nga risqet e integritetit;
2. Burime njerëzore adekuate, të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnime të përshtatshme për t'i rezistuar shkeljeve të integritetit;
3. Transparenca e punës dhe veprimtarisë së Albgaz brenda institucionit, me aktorë të jashtëm të interesuar sic janë operatorët e sektorit dhe institucionet e pavarura (p.sh. ERE) dhe publikun.

3.1 Monitorimi dhe raportimi i Planit të Veprimit

Monitorimi është periodik (çdo vit) dhe përfshin kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve/grupeve të punonjësve përgjegjës për zbatimin e masave të miratuara në planin e veprimit.

Monitorimi do të përcaktojë nëse këto masa të zbatuara kanë qenë eficiente, nëse kanë evidentuar ndryshime të kontekstit të institucionit apo ndryshime të vetë risqeve, të cilat mund të kërkojnë rishikimin e masave ekzistuese dhe prioritetëve të risqeve (planit të veprimit), si edhe nxjerrjen e mësimëve për planifikim më të mirë në të ardhmen.

Raportimi është një procedurë e rregullt që siguron zbatimin e Planit të Integritetit për risqet e integritetit sipas afateve kohore të parashikuara. Ky proces ndiqet nga personi përgjegjës, i caktuar nga titullari i institucionit, i cili është përgjegjës për progresin e zbatimit.

Monitorimi i Planit të Integritetit realizohet një herë në vit nga strukturat përgjegjëse. Raporti vjetor i monitorimit i paraqitet Administratorit të Shoqërisë, i cili vendos për masat përmirësuese të nevojshme. Zbatimi i Planit të Masave Korrigjuese do të monitorohet në mënyrë periodike nga strukturat përgjegjëse të ALBGAS sh.a. nëpërmjet indikatorëve të përcaktuar për secilën masë.

Monitorimi do të fokusohet në:

- progresin e zbatimit të masave;
- realizimin e afateve të përcaktuara;
- arritjen e indikatorëve të monitorimit;
- efektivitetin e masave në reduktimin e nivelit të riskut.

Strukturat përgjegjëse do të raportojnë periodikisht mbi ecurinë e masave dhe do të propozojnë ndërhyrje shtesë në rastet kur risku mbetet i lartë ose evidentohen dobësi të reja në sistemin e integritetit.

Indikatorët e monitorimit:

Masa	Indikator
Konflikti i interesit	Regjistri ekziston dhe përditësohet
Dhuratat	Regjistri ekziston dhe verifikohet
Sinjalizimi	Procedura e publikuar dhe e komunikuar
Trajnimet	Të paktën 1 trajnim në vit
Transparenca	PT përditësohet sipas afateve

Rezultatet e pritshme

Zbatimi i Planit të Masave Korrigjuese pritet të sjellë:

- forcimin e sistemit të integritetit në ALBGAS sh.a.;
- rritjen e ndërgjegjësimit të punonjësve mbi etikën dhe konfliktin e interesit;
- përmirësimin e mekanizmave të sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve;
- rritjen e transparencës institucionale;
- reduktimin e risqeve të identifikuara në Regjistrin e Riskut;

Fusha e kuadrit rregullator të integritetit dhe instrumenteve të luftës kundër korrupsionit

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (Burimi i rrezikut/Tipi i impaktit)	Rreziku Inherent	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatim	Struktura Përgjegjëse	Afati i zbatimit të aktiviteteve
1	Kuadri rregullator mbi mekanizmat e sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve. Mungesa e njohjes së procedurave dhe mekanizmave të mbrojtjes së sinjalizuesve nga punonjësit.	Përputhshmëri dhe Reputacional	Mesatar	1. Hartimi i një programi informimi për punonjësit. 2. Organizimi i takimeve dhe trajnimeve vjetore për mbrojtjen e sinjalizuesve. 3. Publikimi i informacionit mbi procedurat e sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve.	Njësia Përgjegjëse për Sinjalizimin + Burimet Njerëzore	Gjashtëmuji II 2026 dhe në vazhdim
2	Konflikti i interesit dhe mungesa e administrimit të plotë të regjistrit të konfliktit të interesit.	Përputhshmëri dhe Reputacional	Mesatar	1. Krijimi/Përditësimi i regjistrit të konfliktit të interesit. 2. Informimi i punonjësve mbi detyrimet për deklarimin e konfliktit të interesit. 3. Trajnime periodike për kuadrin ligjor në fuqi.	Autoriteti Përgjegjës + Burimet Njerëzore	2026-2029
3	Mungesa e regjistrit të dhuratave dhe njohjes së procedurave për administrimin e tyre.	Operacional dhe Përputhshmëri	Mesatar	1. Krijimi dhe administrimi i regjistrit të dhuratave. 2. Informimi i stafit mbi procedurat e deklarimit dhe administrimit të dhuratave. 3. Monitorimi periodik i zbatimit të procedurave.	Burimet Njerëzore	Gjashtëmuji II 2026 dhe në vazhdim
4	Mosnjohja e mjaftueshme e Kodit të Etikës dhe standardeve të integritetit.	Reputacional	Mesatar	1. Rishikimi periodik i Kodit të Etikës. 2. Organizimi i trajnimeve vjetore për etikën dhe integritetin. 3. Informimi i punonjësve të rinj mbi Kodin e Etikës.	Burimet Njerëzore	2026-2029
5	Nivel i ulët i raportimit të rasteve të sjelljes joetike dhe shkeljeve të integritetit.	Reputacional dhe Operacional	Mesatar	1. Fushata ndërgjegjësuere për integritetin. 2. Promovimi i mekanizmave të raportimit. 3. Forcimi i besimit në sistemin e sinjalizimit.	Grupi i Integritetit	2026-2029

Fusha e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (Burimi i rrezikut/Tipi i impaktit)	Rreziku Inherent	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatim	Struktura Përgjegjëse	Afati i zbatimit të aktiviteteve
1	Mungesa e trajnimeve të mjaftueshme për integritetin, etikën dhe antikorrupsionin.	Operacional	Mesatar	Hartimi dhe zbatimi i planit vjetor të trajnimeve për integritetin, etikën, konfliktin e interesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.	Burimet Njerëzore	2026-2029
2	Mungesa e njohjes së akteve të brendshme rregullatore nga punonjësit.	Operacional	Mesatar	Përgatitja e paketës së akteve të brendshme për punonjësit e rinj dhe informimi periodik për ndryshimet në kuadrin rregullator.	Burimet Njerëzore	2026-2029
3	Rrjedhja e të dhënave personale dhe informacionit konfidencial.	Operacional dhe Reputacional	Mesatar	Trajnime për mbrojtjen e të dhënave personale dhe monitorim i respektimit të procedurave të sigurisë së informacionit.	Burimet Njerëzore + IT	2026-2029
4	Mungesa e procedurave të standardizuara të punës për proceset kryesore.	Operacional	Mesatar	Hartimi dhe përditësimi i procedurave standarde të punës për proceset kryesore të shoqërisë.	Të gjitha drejtoritë	2027

Fusha e Transparencës dhe Llogaridhënies

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (Burimi i rrezikut/Tipi i impaktit)	Rreziku Inherent	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatim	Struktura Përgjegjëse	Afati i zbatimit të aktiviteteve
1	Mospërditësimi i Programit të Transparencës.	Reputacional	Mesatar	Monitorimi periodik dhe përditësimi i Programit të Transparencës sipas kërkesave ligjore.	Koordinatori për të Drejtën e Informimit	2026-2029
2	Vonesa në trajtimin e kërkesave për informacion.	Operacional dhe Reputacional	Mesatar	Përmirësimi i koordinimit ndërmjet strukturave dhe monitorimi i respektimit të afateve ligjore.	Koordinatori për të Drejtën e Informimit	2026-2029
3	Mungesa e konsultimit me grupet e interesit.	Reputacional	Mesatar	Organizimi i takimeve konsultative me grupet e interesit dhe publikimi i rezultateve të konsultimeve.	Drejtoritë Teknike	Çdo vit
4	Mospublikimi i informacionit me interes publik.	Reputacional	Mesatar	Publikimi sistematik dhe përditësimi periodik i informacionit institucional në faqen zyrtare.	Të gjitha strukturat përgjegjëse	2026-2029

Fusha e Menaxhimit të Informacionit dhe Dokumentacionit

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (Burimi i rrezikut/Tipi i impaktit)	Rreziku Inherent	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatim	Struktura Përgjegjëse	Afati i zbatimit të aktiviteteve
1	Administrim i paplotë, humbje, manipulim ose akses i paautorizuar në dokumentacionin institucional dhe informacionin konfidencial.	Operacional dhe Reputacional	Mesatar	1. Rishikimi dhe përditësimi i procedurave për administrimin dhe arkivimin e dokumentacionit. 2. Evidentimi dhe monitorimi periodik i të drejtave të aksesit në informacion dhe dokumentacion. 3. Kryerja e auditimeve periodike mbi menaxhimin e informacionit dhe dokumentacionit.	Protokoll-Arkiva / Njësia IT	2026-2029

Fusha e Operimit Sektorial të ALBGAS

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (Burimi i rrezikut/Tipi i impaktit)	Rreziku Inherent	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatim	Struktura Përgjegjëse	Afati i zbatimit të aktiviteteve
1	Mungesë transparence, konflikt interesi ose ushtrim i diskrecionit të pajustificuar në proceset teknike dhe operacionale të lidhura me aktivitetin e transmetimit dhe infrastrukturës së gazit natyror.	Operacional, Përputhshmëri dhe Reputacional	Mesatar	1. Dokumentimi dhe gjurmueshmëria e plotë e proceseve teknike dhe operacionale. 2. Zbatimi i parimit të kontrollit të dyfishtë ("katër syve") për vendimarrjet me ndikim të lartë. 3. Deklarimi i konfliktit të interesit nga personat e përfshirë në procese sensitive.	Drejtoria Teknike dhe Operacionale	2026-2029